

DOKUDAILY

NUMRI I SHTATË

EDICIONI XXIV

E ENJTE, 7 GUSHT 2025



Rekomandime

Faqe 03

Short Film Forum

Faqe 05

Future is Here

Faqe 06

FOTO: FERDI LIMANI

4:30 e mëngjesit, e diel.

Sapo hyra në hotel. Ndërsa po çpaketoj valixhet, e kuptoj që fortësa, dikur e ndërtuar për të larguar vdekjen, tani shkëlqen me jetë në të gjithë qytetin me 100Hz. Ky vend gjithmonë gjen një mënyrë për të më mirëpritur. Ndoshta ai libër i kuq e bëri një pakt.

Ndërsa shtrihem, dëgjohej thirrja për lutje, e sinkronizuar në mënyrë të përkryer me ritmin e fortesës. Këngë e shenjtë dhe muzikë djallëzore, të detyruara në harmoni. Dhe Zoti e di që nuk jam besimtar, por në atë moment, ndjeva se universi kishte diçka për të më thënë.

Filmat janë psalme dhe njerëzit janë ritmi.

Në diversitetin e asaj që shfaqet çdo vit, Dokufest hap zona rezonance midis realiteteve që mendonim se ishin të kundërta. Na tregon se mund të bashkëjetojmë pa zhbërë njëri-tjetrin.

Unë jam lutja e heshtur dhe Kosova është fryma ime.

Hapi im i parë këtu gjatë natën; në momentin që mbërrita, dritat e qytetit u fikën. Flasim për një shenjë. Sikur dikush donte që unë të shihja sa i bukur është ky vend në errësirë. Dhe unë kam parë.

Ne jemi himnet. Bota është tempoja.

Sa kuptim ka në të vërtetë e gjithë kjo? Një ditë, universi do të gjejë një mënyrë për të na imponuar paqen. Mund të jetë gjë mençur, mund të ecim përpara.

Lutje 128 bpm
Çka është e përmbysur është e shenjtë.

Rroftë Dokufest!

Shkruar nga Jeremy Lauricheese



REKOMANDIME

Canone effimero
SLANTED & ENCHANTED: MUSIC ON FILM



DOKUKINO 10:00

SPORT ON FILM



KINO LUMI 20:00

Through Our Kosovo
SPECIAL SCREENINGS



DOKUKINO PLATO 20:30

Palace of Youth
SLANTED & ENCHANTED: MUSIC ON FILM




DOKUKINO PLATO 21:00

Against the Void: How Artists Resist Numbness
DOKUTALKS



SHKOLLA E MUZIKËS 'LORENC ANTONI' 17:00

LUXE x upsammy
DOKUNIGHTS



SONAR STAGE 22:30

DOKUTALKS

Çfarë do të thotë të shikosh?
Të shikosh do të thotë të kujdesesh!

Në një botë të mbingarkuar me imazhe, nga videot e TikTok-ut deri te sulmet me dron, çfarë do të thotë me të vërtetë të shikosh? Kush është ai që shikon, dhe kush është ai që po shikohet?

Paneli i sivjetmë i DokuTalks në DokuFest, i mbajtur më 6 gusht në Shkollën e Muzikës 'Lorenc Antoni', mbledhi së bashku filmbërës dhe mendimtarë që po përballen me një nga pyetjet më urgjente etike të kohës sonë: në një epokë të dhunës së normalizuar dhe indiferencës, si mund të ndërhyjë filmi për të thyer ciklin e apatisë?

Paneli i titulluar Çfarë do të thotë të shikosh?, i moderuar nga Dea Gjnovci, solli së bashku zëra të fuqishëm si Lyuba Knorozok (Special Operation), Juliette Le Monnier (Ramallah, Palestine, December 2018), dhe bashkë-regjisorët Corinne van Egeraat & Petr Lom (The Coriolis Effect). Secili prej tyre solli një këndvështrim radikalisht të ndryshëm, por të gjithë u bashkuan në një pikë: fuqinë dhe përgjegjësinë e dokumentimit në kohë krize.

Për Lyuba Knorozok, historia nisi me heshtjen, me pamjet e vëzhgimit nga Termocentrali Bërthamor i Çernobilit, i cili u pushtua gjatë orëve të para të agresionit të plotë të Rusisë ndaj Ukrainës. "Ne morëm mbi 700 orë material filmik me rezolucion të lartë," ndau Knorozok. "Nuk ishte vetëm dokumentim. Ishte rezistencë".

Pamjet, të kapura dhe ruajtura nga punonjësit e centralit duke rrezikuar jetën e tyre, përbëjnë shtyllën qendrore të filmit Special Operation. Punonjësit, ndërkohë që operonin centralin, po e dokumentonin fshehurazi pushtimin, duke përmbysur narrativën: ndërsa ishin të mbajtur peng, ata ishin gjithashtu duke vëzhguar në heshtje kapësit e tyre. "Çdo kuadër është një akt terrori bërthamor", tha Knorozok, duke iu referuar ligjeve ndërkombëtare që ndalojnë praninë ushtarake në objektet bërthamore.

Nga Ukraina në Palestinë, Juliette Le Monnier solli një qasje minimaliste por jashtëzakonisht të fuqishme në filmin Ramallah, Palestine, December 2018, një film i shkurtër 10-minutësh i xhiruar me një plan të vetëm.

"Isha vetëm unë, duke mbajtur kamerën", tha Le Monnier. Filmi hapet me njerëz që shikojnë diçka jashtë ekranit, dhe shumë shpejt, edhe vetë shikuesi bëhet njëkohësisht pjesëmarrës dhe i huaj ndaj ngjarjes.

Ky plan i pandërprerë shndërrohet në një meditim mbi pafuqinë, dokumentimin dhe brishtësinë e perspektivës.

"U drejtova nga kamera për të kuptuar sadopak kaosin që po ndodhte para meje," tha ajo. Dhe përmes këtij akti, ajo ngre pyetje të parehatshme por thelbësore: Çfarë do të thotë të filmosh dhunën? Çfarë ndodh me rolin e regjisorit kur dëshmimi vetë bëhet akt rezistence?

Duke reflektuar mbi konfliktin e vazhdueshëm në Palestinë dhe përgjegjësinë etike të kineastëve, ajo shtoi: "Nuk ka të bëjë vetëm me kapjen e vuajtjes. Ka të bëjë me refuzimin për të heshtur. Edhe filmat e vegjël mund të jenë akte proteste."

Filmi The Coriolis Effect i Corinne van Egeraat dhe Petr Lom e çoi bisedën në një orbitë tjetër, në kuptimin më të drejtpërdrejtë të fjalës. I xhiruar në Cape Verde, filmi eksploron brishtësinë e planetit përmes një lenteje poetike dhe jo-njerëz-qendrore. "Është një meditimi mbi jetën në syrin e stuhisë", shpjegoi Lom. Kamera e tyre nuk kërkon protagonistë apo kulme dramatike por zhytet nën ujë, noton në ajër, zvarritet mbi tokë.

"Dëshirojam që shikuesit të ndiheshin pjesë e diçkaje më të madhe, diçkaje thellësisht të ndërlidhur," tha van Egeraat.

Në kontrast me realizmin e drejtpërdrejtë dhe të ngutshëm të pamjeve të luftës, filmi i tyre është si një lutje vizuale. Ai ngjall magjinë e padukshme të ekzistencës, duke dhënë një paralajmërim të heshtur mbi krizën klimatike.

Biseda mori një kthesë serioze kur panelistët diskutuan ndërthurjen mes artit dhe drejtësisë. Knorozok foli për bashkëpunimin me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Ukrainës, duke përdorur filmin si provë ligjore për krime lufte.

"Edhe nëse filmi nuk merr vëmendje globale," tha ajo, "ai ruan kujtesën. Dhe kjo, në vetvete, është drejtësi." Le Monnier përforcoi këtë ndjesi. Në një botë të mediave të filtruar dhe vëmendjes së përkohshme, dokumentarët kanë fuqinë të depërtojnë qoftë edhe për një moment dhe të kërkojnë reflektim. Ndërkohë, van Egeraat theksoi se rrëfimi i tregimeve nuk ka nevojë të bërtasë për t'u dëgjuar.

Paneli u përmyll me një sesion të gjallë pyetje-përgjigje, që eksploroji mënyrat se si festivalet si DokuFest mund të angazhojnë gjeneratat e reja dhe të ofrojnë narrativa alternative.

"Jo të gjithë lidhen me kinemanë e ngadaltë", tha dikush nga publiku, "por kjo nuk do të thotë që duhet të ndalojmë së provuari".

Qoftë përmes pamjeve të sigurisë të rikonstektualizuara për drejtësi, vëzhgimeve të thjeshta të shndërruara në poezi, apo meditimeve nën ujë për jetën vetë, këta filmbërës na sfidojnë të rishqyrtojmë se si shikojmë dhe çfarë zgjedhim të mos shohim.

Në fund të fundit, të shikosh nuk është akt pasiv. Është akt moral. Dhe paneli "Çfarë do të thotë të shikosh?" i DokuFest-it e bëri një gjë kristal të qartë: të shikosh është të kujdesesh dhe nganjëherë, të kujdesesh është hapi i parë drejt ndryshimit.

SHORT FILM FORUM

Debutimi premtues i Forumit për Filma të Shkurtër sjell vizione të reja nga Ballkani



Për herë të parë në rajon, Forumi i Filmit të Shkurtër, një platformë e re rajonale për bashkëprodhim dhe prezantim projektsh, përmbylli me sukses edicionin e tij debutues gjatë edicionit të 24-të të DokuFest-it, që u mbajt në Prizren nga 4 deri më 6 gusht 2025. I krijuar për të mbështetur dhe lidhur filmbërësit e rinj nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, forumi solli në vëmendje një spektër të larmishëm tregimesh në zhanret e fiksionit, dokumentarit, animacionit, formave hibride dhe eksperimentale.

I menduar si një qendër rajonale për zhvillimin e filmave të shkurtër, forumi ishte realizim i një ideje të kamotshme të DokuFest-it.

"Gjithmonë kemi pasur këtë ëndërr për të krijuar diçka të ngjashme me atë që bëhet në vendet nordike," tha Eroll Bilibani nga DokuFest gjatë ditës së fundit të forumit. "Për arsye politike, kjo nuk ndodhi kurrë, deri më tani. Jam thellësisht mirënjohës për partnerët tanë në Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Shqipëri. Dhe në veçanti për Qendrën Kinematografike të Malit të Zi, e cila tashmë ka konfirmuar pjesëmarrjen për vitin e ardhshëm". Forumi u iniciua në qershor të vitit 2025 dhe vazhdoi me një program fizik në Prizren, i cili mbledhi së bashku filmbërësit e përzgjedhur për mentorim, zhvillim dhe rrjetëzim me industrinë. Sesionet e prezantimeve (pitching), të mbajtura në ditën e fundit, u moderuan nga Jing Haase, e cila i udhëhoqi ekipet pjesëmarrëse nëpër këtë proces. "Ata janë mentoruar nga Martijn te Pas, kanë ushtruar dhe përsosur prezantimet e tyre, dhe tani janë gati", njoftoi Haase. "Pas prezantimeve, do të ketë pyetje nga juria, dhe në fund do të ndahen shtatë çmime, tre financiare dhe katër të mbështetura nga industria." Dita përmbyllëse kulmoi me një ceremoni festive ndarjeje çmimesh, duke vënë në pah talentin dhe premtimin e zërave të rinj të rajonit.

Çdo çmim ishte njëherësh një vlerësim dhe një trampolinë drejt zhvillimit të mëtejshëm dhe bashkëpunimeve të reja.

Nominimi për Euro Connection gjatë Tregut të Filmit të Shkurtër në Clermont-Ferrand, Francë iu dha filmit "I Still Haven't Cry" nga regjisorja Flaka Kokolli (Kosovë).

"E dua DokuFest-in dhe gjithçka që bëni për të gjitha llojet e filmave. Unë bëj animacion, dhe jam shumë e lumtur që gjithmonë përfshini edhe animacionin. Dhe për të gjitha bashkëpunimet që kemi pasur, është gjithmonë kënaqësi", tha Kokolli.

Çmimi i Shoqatës Evropiane të Dokumentarit (Documentary Association of Europe Award), i cili përfshin akreditim dhe akomodim për AGORA MARKET të Festivalit të Filmit në Selanik iu dha filmit Discobox nga regjisorja Romina Ruda (Shqipëri).

"Kjo është kaq argëtuese. Faleminderit shumë. Oh Zot, mezi pres t'ju takoj në Selanik!", e shpreh ajo.

Ftesa për të prezantuar në sesionin "You Only Pitch Twice" të ShorTO Film Market, e përzgjedhur nga Qendra Italiane e Filmit të Shkurtër, iu dha filmit "Who is singing?" nga regjisorja Ana Morina (Kosovë).

"Faleminderit. Faleminderit Anitës dhe të gjithëve që tashmë janë pjesë e projektit. Kjo është shumë emocionuese."

Çmimi për Strategjinë për Festivete nga Square Eyes, që përfshin dy sesione këshilluese dhe një strategji të personalizuar për festivale shkoi te projekti "Soil" nga regjisorët Kiril Karakash dhe Svetislav Podleshanov (Maqedonia e Veriut).

"Faleminderit. Para së gjithash dëshirojmë të falënderojmë gjithë ekipin e DokuFest-it dhe të gjithë ata që u përfshinë në realizimin e këtij forumi të parë për filma të shkurtër. Jemi shumë të lumtur që jemi këtu dhe mezi presim të shihemi sërish vitin e ardhshëm."

Çmimi Talent Doc, i ndarë nga Qendra Kinematografike e Kosovës, iu dha filmit "Soundtrack of a People: Boom" nga regjisorja Fjolla Muharremi (Kosovë).

Çmimi për Prezantimin më të mirë, Talent i ri në filmbërje, i ndarë nga DokuFest dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, iu dha filmit "Sveti Antun Pustinjak" nga regjisori Antonio Dimovski (Maqedonia e Veriut).

"Dua të them faleminderit shumë të gjithëve. Kjo është hera ime e parë në Kosovë. Dhe që nga momenti i parë që kam ardhur, jam ndjerë si në shtëpi. Jam jashtëzakonisht mirënjohës për këtë mundësi. Mezi pres për bashkëpunime në të ardhmen – dhe për të përfaqësuar atë që ky forum përfaqëson: bashkëpunimin në Ballkan", tha Dimovski.

Çmimi për Projektin më të Mirë – Forca Krijuese, i ndarë nga DokuFest dhe Ambasada Suedeze në Kosovë, iu dha filmit "Who is singing?" nga regjisorja Ana Morina (Kosovë).

"Faleminderit DokuFest për këto mundësi. Jam shumë e emocionuar. Është kënaqësi të jem këtu. Çdo herë që vij, ndihem si në shtëpi. Prandaj, faleminderit shumë". Edhe pse ky ishte vetëm edicioni i parë, energjia dhe potenciali që u çliruan nuk lanë asnjë dyshim se Forumi i Filmit të Shkurtër do të jetë një ngjarje që do të vazhdojë. Takimet një-më-një midis vendimmarrësve dhe filmbërësve u mundësuan gjithashtu, duke mbjellë farat për bashkëprodhime dhe mbështetje të ardhshme nga industria.

"Ky është vetëm fillimi," përfundoi Eroll Bilibani. "Në thelb të gjitha projektet janë fituese. Dhe vitin e ardhshëm, me përfshirjen e Malit të Zi, do të jemi edhe më të fortë."

Ndërsa dielli perëndonte mbi Prizren, filmbërësit dhe anëtarët e jurisë festuan jo vetëm përmbylljen e forumit, por edhe fillimin e një epoke të re për krijimin e filmave të shkurtër në Ballkan, një epokë ku kufijtë zbehen, tregimet ngrihen lart dhe kreativiteti është e vetmja pasaportë që duhet.

FUTURE IS HERE

Me sytë nga e ardhmja, gjenerata e re e filmbërësve sjell shpirtin në ekran



PHOTO: FERDI LIMANI

Eshtë një nga momentet më emocionuese të vitit, të parit e filmave të gjeneratave të reja të Future is Here në DokuFest. Kësaj radhe gjenerata e trembëdhjetë na tregon rrugën drejt rrëfimeve të tyre. Ata kanë qenë në Prizren për një kohë të gjatë për të patur punët e tyre të mentoruara nga Eroll Bilibani, Dea Gjinovci, Leart Rama dhe Flutura Balaj, të cilët kanë qenë pjesë e pandashme e procesit emocionues e të zhvilluarit një, për shumë filmin e tyre të parë.

Në Kino Lumi, më së pari ndoqëm programin Bridging the Gap, me pesë filma nga Skocia duke filluar me "Friends on the Outside" me regji të Annabel Moodie, mandej me "The Bayview" me regji të Daniel Cook, "A Long Winter" me regji të Eilidh Monroe, "Hole in the Stone" me regji të Holly Marie Parnell dhe "Pink Moon" me regji të Meray Diner. Një përkapje e jetëve periferike, në dukje të acarta, të largëta nga zhurmat e urbanitetit, por themelisht njerëzore dhe të prekshme. Ky program i realizuar në bashkëpunim me Scottish Documentary Institute, sjell më të mirën e filmbërësve skocezë drejt e në Prizren.

Por emocionet e filmbërësve të rinj të Future is Here ndiheshin në ajër, e kështu ne u njohëm me punën e Suara Ismailit me titullin "Mes Nesh", një rrëfim për një marrëdhënien mes regjisores dhe mamasë së saj teksa punojnë në një studio pikturë duke e thelluar paraqitjen e këtij raporti, jo vetëm në lidhje gjaku, por edhe në lidhje artistike dhe intelektuale. Më tej vijua me filmin "Dritë në Errësirë" të Erlisa Buzhalës, që na fton të përjetojmë botën ashtu sikurse ajo e përjeton, me limitimet e saj në shikim. Dhe e njohim forcën, durimin dhe vulnerabilitetin e Erlisës në plotësi.

"Tavani" nga Lekë Cërvadiku na njeh me një përjetim personal dhe emocional të një hapësire që mban kujtime, histori dhe shumë nostalgji." Shpesh ndër vite kemi parë dhe dokumentime të jetëve të njerëzve që jetojnë në rrethana që mund të duken të pazakonta, por që rrjedhin butësisht në kohë me shumë qëndrueshmëri. E një e tillë ishte dhe dokumentimi i disa momenteve nga jeta e Donjeta Krasniqit, pjesë e Forcave Speciale të Kosovës, e përkapur në film nga regjisorja e re Diellza Musliu, në filmin e titulluar "Her". Edhe qasjet eksperimentale sonore janë pjesë e hulumtimit të kësaj gjenerate e sidomos me filmin "Tingëllimë" me regji të Blertë Ibrahimit,

që përmbledh në mënyrë metaforike se si vetëm përmes tingujve mund të kuptojmë se jemi në shtëpi e kësaj të përjetonim në formë thellësisht ndjesore një hapësirë sa intime, por edhe aq kolektive.

Pas këtij reflektimi, ndoqëm bisedën e një tresheje fantastike, të Erzës, Erenikut dhe Andit teksa tregojnë historitë e tyre fantastike të shoqëruara në një film me plot humor dhe shpirt, të titulluar "3 në 1".

E shfaqja e fundit ishte e dedikuar hapësirës sociale Termokiss në Prishtinë e titulluar "TermoKiss has no Borders" me regji të Korab Jasharit dhe Tea Jasharit, e që reflektojnë mbi format e aktivizimit dhe përgjegjësisë shoqërore.

Pas shfaqjes së filmave, salla e Kino Lumit u mbush në duartrokitje teksa Eroll Bilibani ftoi gjeneratën e re të ngjitej në skenë së bashku me mentorët e tyre. Dea Gjinovci tha "Jam shumë e impresionuar nga punët tuaja. Ka qenë kënaqësi t'ju shihja në fillim të nisjes së këtij programi, dhe se si i transformuam idetë tuaja mbi se si mund të zhvillonit projektet tuaja më tej dhe se këto histori janë unike sepse janë tuajat dhe jam shumë krenare për ju."

Leart Rama, i cili ka qenë po ashtu pjesë e Future is Here vite më parë, e tanimë prej vitesh mentor i gjeneratave të reja tha se: "Jemi shumë krenarë me punën që keni bërë dhe se kemi qenë shumë me fat me të gjithë ju e uroj të shoh më shumë projekte prej jush në të ardhmen".

Po ashtu, si Rama, edhe Flutura Balaj ka qenë pjesë e programit të Future is Here dhe ka qenë pjesë e rëndësishme e punëve të të rinjve si editore e ajo tha: "I bashkohem kësaj ndjesie të krenarie dhe vijojmë të njohim adoleshentë që janë të sigurt në vizionin e tyre e po ashtu jam krenare se sa shumë të determinuar janë këta të rinj mbi se si donin të dukeshin filmat e tyre."

Filmbërësit e rinj ndanë me ne emocionet e tyre të para me ne në skenë duke shprehur falenderimet e tyre për këdo ka suportuar projektet e tyre e me këto ndjesi të fluturave në bark, mezi presim se si do të duken të ardhmet e tyre në film.

MBI
FILMAT

Përmes Kosovës Sonë (Through our Kosovo)



Nuk ka të dhëna për zhvillime në fushën e kinematografisë në Kosovë para vitit 1912. Megjithatë, pas Luftërave Ballkanike, prania e kamerave të filmit në rajon u bë e mundur. Megjithatë, këto të dhëna të hershme vizuale janë të kufizuara, kryesisht të fokusuara në luftë, dhe përbëhen nga sekuenca të shkurtra që kryesisht nuk kanë mbijetuar deri në ditët e sotme.

Ky rrëfim i fragmentuar dhe i përqendruar në luftë filloi të ndryshonte pjesërisht në vitet '30 duke theksuar rritjen e vëmendjes së strukturave shtetërore në fushën e kinemasë. Në vitin 1931, "Ligji për Rregullimin e Tregtisë së Filmit" krijoi një kornizë ligjore për kinemanë, duke sjellë më shumë strukturë në këtë fushë.

Po atë vit, "Filmi Edukativ Jugosllav", i themeluar nën Zyrën Qendrore të Shtypit të Mbretërisë së Jugosllavisë, prodhoi filma të shumtë që dokumentonin Kosovën. Ndër më të shquarit janë "Në Prizrenin e Vjetër" (U Starom Prizrenu, 1932) dhe "Nga Fusha e Kosovës deri në Liqenin e Ohrit" (Od Kosova Polja do Ohridskog Jezera, 1934). Një tjetër vepër e rëndësishme që paraqet disa nga pamjet më të vjetra të mbijetuara të Kosovës është dokumentari i vitit 1933 "Përmes Kosovës Sonë" (Kroz naše Kosovo). Ky film u prodhua nga Shkolla e Shëndetit Publik (Škola narodnog zdravlja), e cila u themelua në Zagreb në vitin 1926 me mbështetjen e Fondacionit Rockefeller, nën udhëheqjen e Dr. Andrija Štampar. Fillimisht e fokusuar në prodhimin e filmave edukativë shëndetësorë, shkolla u zgjerua në krijimin e filmave dokumentarë në vitet 1930.

"Përmes Kosovës Tonë" është një film pa zë prej afërsisht 25 minutash, me skenar dhe u drejtua nga Dr. Drago Chloupek, me kinematografi nga Aleksandar Gerasimov. Filmi dokumenton qytete dhe rajone si Prishtina, Janjeva, Lipjani, Mitrovica, Ferizaj, Trepça dhe Graçanica dhe shfaq xhamitë dhe kishat, jetën e përditshme shumëkulturore, zanatet tradicionale, bujqësinë dhe blegtorinë. Vizualisht, filmi është i shquar për cilësinë e tij fotografike, montazhin koherent dhe kompozimin estetik. Megjithatë, titujt e filmit janë të mbushur me gjuhë propagandistike dhe pasqyrojnë klimën politike të kohës. Pavarësisht kësaj, "Përmes Kosovës Sonë" mbetet një nga të dhënat vizuale më gjithëpërfshirëse të rajonit gjatë asaj periudhe.

Filmi do të paraqitet së bashku me një performancë muzikore të luajtur drejtpërsëdrejti, të kompozuar nga Ilir Bajri dhe të interpretuar nga Ansambli Eksperimental. Ansambli Eksperimental është një nismë e Fondacionit Lumbardhi, i cili organizon çdo vit ngjarje eksperimentale që bashkojnë materialin vizual arkivor me muzikën.

Shënim: Pjesa më e madhe e informacionit të paraqitur në këtë tekst rreth aktivitetit kinematografik në Kosovë para vitit 1945 bazohet në librat dhe artikujt e Dejan Kosanović.

Shkruar nga Bengi Muzbeg

MBI
FILMAT

Nga një kinema në tjetrën - tre vite rresht

BISEDË ME URATA KAJTAZIN



Shpesh ne fokusohemi në ata që bëjnë filma, që merren me lëminë e të shkruarit, me ata që bëjnë të pamundurën për të kapërcyer muret e granteve, fondeve që rrëfimet që regjisorë e artistë të ndryshëm t'i sjellin në ekran. Duhet gjithmonë ta dimë se ka një punë kolosale nga pas. Dhe e gjitha kjo që të gjejnë sy kuriozë e të vëmendshëm për t'i parë, e ne në DokuDaily e njohim një person të tillë. E ajo është Urata. Për ata që e njohin së afërmi Uratën, e dinë se për gjërat të cilat ajo është e apasionuar e gjen një formë shumë të organizuar për t'i shijuar në themeli.

Urata Kajtazi, e cila më parë ka punuar në departamentin e mikpritjes në DokuFest, prej mëse tre vitesh, ndjek rregullisht gjithë çfarë mundet në DokuFest. Programet e saj janë të mbushura plot me shënime, me detaje, të strukturara në kode ngjyrash. Ajo thotë se parapërgatitja për të parë filmat, nis që prej momentin që publikohet programi dhe ja nis të orientohet duke zënë fill me kategorinë e Human Rights Dox, pasi kjo kategori mban në masë filmat e preferuar të saj. "Histori të vërteta, që vijnë prej njerëzve" - thotë ajo.

E në fakt, kjo rutinë që ndërthur në të njëmijë rrugë të pazakonta në ekran, është një hobi, i mirërenduar falë natyrës së saj, që kërkon rend në botë. Dhe zakonisht Urata e gjen dhe e vendos rendin në botë.

Kur e pyesim për mënyrën se si natyra e filmave apo e atmosferës së festivalit është ndier ndër vite, ajo thotë se, filmat janë atmosfera për të, sidomos dy vitet e kaluara. Duke qenë pjesë e stafit, vite më parë, për shkak të ngarkesës së zakonshme të festivaleve, ikja në kinema dukej si dëshirë e përditshme, por jo dhe aq e mundshme. Fokusi në vite të ndryshme lidhur me tematikat i vërehet ndryshimi duke cekur filmat e shumtë për Palestinën vitin e kaluar e këtë vit me shumë filma mbi Iranin, dy vite më parë në atë shortin e organizuar të agjendës së të parit filma, kanë qëlluar filma të shkurtër ndërkombëtarë. Vitin e kaluar, duke bërë llogarinë me laps në dorë ajo ka parë 64 filma. Por numrat nuk kanë rëndësi, sepse si shprehet dhe ajo ka rëndësi që numri i njerëzve në kinema është rritur e për këtë duhet të ndihemi mirë.

Urata na shpjegon mekanizmin se si i përzgjedh filmat duke mbajtur programin në dorë: "Me ngjyrë të kaltërt shënoj sinopsin paraprakisht, me ngjyrë të kuqe shënoj kur është repriza dhe me ngjyrë të zezë shënoj mendimet e mia mbi filmin, ose ndonjë fjali që më ka mbet në krye." E pyesim se deri më tani cilat filma ka pëlqyer më së shumti dhe cek "Cutting through Rocks",

Të gjitha filmat në International Short Dox dhe Blue Heart. Edhe Hipopotami, që është shumë i errët, por mua më pëlqejnë gjërat e errëta.

Natyrisht, metoda shtrihet edhe në mënyrën se si ndërveprohet me hapësirën e kinemasë ndaj me shumë gjasa Uratën e gjeni në DokuKino në rreshtin e parafundit, në mes, sepse është pamja më e mirë sipas saj. Te Shtëpia e Kulturës, ulet në rresht të parë të pjesës së dytë të formacionit të ulëseve. As larg, as afër. Në të tjerat, sa më prapa dhe në mes.

Ajo nuk i honeps kur ia rrëfen se si historia ndodh. No spoilers, please. Nuk ka qejf kur njerëzit çohen në mes të filmit. Dhe ka të drejtë. Nëse e di se sa zgjat filmi dhe ke marrë nismën ta ndjekësh, çfarë mund ta shtyjë dikë të dalë menjëherë? Po ashtu nuk i ka qejf njerëzit që bëjnë komente të ekzagjeruara në kinema. Kjo është diçka që nuk duhet të bëni. Së paku jo në praninë e Uratës, pasi ajo edhe nëse nuk i pëlqen një film, qëndron deri në fund, pasi i jap një shans se fundi ndoshta ndryshon.

Për këtë ka një vend dhe është jashtë kinemasë. Kur dritat ulen dhe ekrani ndizet, sytë duhet të ndjekin rrëfimin. Duke qenë frekuentuese e rregullt e kinemasë, e sidomos e programeve të DokuFest, e sheh mes të qenurit pjesë e stafit dhe si "turiste" në qytetin e vet, e sheh që kjo dashuri për festivalin i është transformuar në forma të ndryshme. Paçka se nuk e mban në mend filmin e parë që ka parë në DokuFest ajo nuk rresht së rekomanduar filmin "Our Males and Females" me regji të Ahmad Alyaseer.

Në mes të gjeturit një balance mes të parit filma dhe kohës me shoqërinë, ne e vërejmë këtë marrëdhënie të shëndetshme, të urtë dhe plot kuriozitet që Urata ka duke mos harruar që mprehtësia e saj karakteriale nuk toleron pasinqeritet. Ajo shprehet lirshëm mbi nevojën e të paturit një narrator në film. Mbi të kup-tuarit e kontekstit. Mbi të mësuarit pa patur nevojën për të mbi-estetizuar imazhin.

Nuk sheh lajme prej vitesh. Ajo na thotë se këtë e ka zëvendësuar në mënyrë shumë të natyrshme të parit e filmave dokumentarë. Është larg botës online. I intereson më shumë perspektiva e imët dhe e thellë që vjen nga të katërta anët e botës e drejt e në Prizren.

Nëse e shihni Uratën nëpër kinematë e festivalit, ju lutemi, lëreni të qetë. Është në pushimin e saj të merituar dhe po mendon se cilin film të radhës nuk duhet të humbasë.

DOKUNIGHTS

Magji në kala



FOTO: SARA ÇAFLESHI

Nuk do të pretendoj se e di se si Cinna Peyghamy i krijoi tingujt mbrëmë duke përdorur vetëm tombakun e tij - një daulle të vogël persiane - dhe një sintetizues modular, as nuk do ta kuptoj se si peizazhet tingëlluese, drithëruese dhe pulsuese të projektura nga YAAND (Anda Kryeziu) dhe urbau në setet që pasuan në një farë mënyre ndiheshin si të lirshme ashtu edhe të punuara me mjeshtëri, por, të përkapur në mjegullën e tyre atmosferike, e gjeta veten të dhënë pas asaj muzike, duke përthithur gjithë magjinë e të gjithës. Nuk është muzikë e tillë që duhet të përsiatet nëpër intelektualizma, por duhej thithur, duke i lënë dridhjet të jehojnë nëpër trup dhe në shpirt.

Peyghamy, i ulur këmbëkryq në tarracën e tij në pjesën e përparme të Sonar Stage, me tombakun në prehër, formësoi një figurë të thjeshtë: "Përsëritet, unë jam Cinna. Do të luaj pak muzikë", filloi ai, duke u shprehur modestisht, thua se nuk e ndiem magjinë që luajti për pothuaj një orë. Me Tombakun si mjetin e tij, moria e ndjesive që përcolli ishte e mahnitshme, duke lëshuar ritme intensivisht magjepsëse të kthyer nga sintetizeri i tij modular. Së pari, një ngritje e pika-pika dhe intriguese dhe pastaj një ekstazë e plotë: copa xhami të thyer, jehonë e ritmeve familjare dhe, disi, tonet e asaj që tingëllonte si një sitar, të gjitha dukeshin të improvizuara.

YAAND vijoi në të njëjtin ritëm, e rrethuar nga mjegull e dendur dhe rreze drite, duke vënë në skenë një tjetër performancë të vazhdueshme dhe të guximshme që lëkundej në një spektër të tërë të muzikës eksperimentale me lehtësi të vërejtshme.

Duke përfshirë fjalë të thëna në mënyrë therëse midis një mori glitch-esh dhe elementesh hiperpopi, ajo na befasoi duke e llastuar tingullin me gjurmë të breakbeat dhe techno para se të kthehej pas, ose, në një sekuencë veçanërisht të habitshme, të lirshme, duke u rehatuar në vokale të shtresuara dhe linja sintetizeri të lartë - një moment eteraliteti i pastër.

Urbau, në përgjigje, erdhi me një fuqi të jashtëzakonshme, me dëshirë për kaos, eksplorim dhe transshendentalizëm. Duke luajtur me këtë mospërputhje dhe krijuar një atmosferë intensive, performanca e tij ishte e pasur me teksturë dhe vazhdimisht në ndryshim, duke ofruar ritme pulsuese midis melodive zanore në rritje ose duke u shpërbërë plotësisht në një mjegull zhurme. Seti i tij përmbledhi të gjithë natën: pa frikë të marrë kthesa të guximshme, me shumë stil e madhështi dhe i mbushur me ndjesi eklektike, eksperimentale dhe marramendëse - tipike e një DokuNight klasik.

Sonte, eksplorimi sonor vijon e do të njihemi me dy producentë të njohur elektronikë në kulmin e lojës së tyre muzikore. Së pari, do të jetë LUXE artisti eksperimental me bazë në Londër e do të performojë live duke e sfiduar zhanrin: duke bashkuar kompozimet klasike me peizazhe akustike dhe ritme elektronike me tempo të lartë, përpara se të na prezantojnë jehonat dhe mikrotekstet e harlisura, introspektive të artistes me bazë në Amsterdam, Upsammy, e cila prezanton një interpretim live, audiovizual të albumit të saj mahnitës të vitit 2024, Strange Meridians. Kjo natë vjen e kuruar personalisht nga bashkëkurator i DokuNights duke e theksuar që kjo është një natë që nuk duhet humbur.

Shkruar nga Gus Edgar-Chan



FOTO: SARA ÇAFLESHI

INTERVISTË

Kthim në DokuFest

NJË BISEDË ME MATEJA RAIČKOVIĆ



FOTO: LUKA STRIKA

Kthim te kjo. Takim me regjisorët ndërsa sapo kishin mbërritur në Prizren. Dhe kështu është edhe me Mateja Raičković-in. Herën e parë që erdhi në DokuFest, ajo shkoi direkt në DokuNights. Dje, ajo iu bashkua turmave të ngjeshura të natës në Prizren.

Ajo thotë: "DokuFest për mua është shumë i veçantë dhe jam e nderuar që vij këtë vit me filmin, sepse hera e parë që u prezantova në festival ishte kur sapo kisha filluar studimet e mia bachelor në Mal të Zi, në qytet dhe pati një thirrje për një seminar dokumentarësh. Në atë moment, nuk e dija se çfarë ishin saktësisht dokumentarët. Mendova se ishin thjesht, e dini, reportazhet që shihni në TV, si gjërat e mërzitshme. Po, flet, mëson diçka të re dhe kaq, dhe kaq. Por prapë vendosa të vij sepse në shkollën tonë nuk kishim asnjë kurs për film dokumentar, kështu që në të vërtetë doja të mësoja. Dhe pastaj e gjithë bota m'u hap."

Herën e parë që ajo mori guximin të prekte kamerën dhe të shkonte të xhironte, ishte gjatë viteve të studimit, duke përjetuar një moment kurioziteti dhe duke u përpjekur të bashkëpunonte me njerëzit, ata bënë një film për peshkatarët në Mal të Zi. Dhe përfundoi duke qenë mjaft i bukur. Dhe kjo ishte mënyra se si erdha në DokuFest. Ajo kujton ardhjen në edicion kur episodet e fushatës "E vërteta qëndron këtu" ishin kudo, dhe ajo ende e mban atë afishe në laptopin e saj. Ajo ndjeu një ndjesi të menjëhershme familjariteti. Edhe pjesët kur qyteti duket se është gjithmonë në një situatë ndërtimi. Por ajo që i pëlqen më shumë janë stendat e misrit të pjekur në qytet. Ndihet si verë, si shtëpi.

Vitin e kaluar ajo punoi në Dokufest, këtë vit ajo është pjesë e konkursit Balkan Dox me filmin e saj "Lavander" që merret me historinë delikate dhe të vështirë të jetës reale të regjisores. Është prekës dhe merret me përvojën e saj traumatike të kapërcimit të shkeljes, një sekret që e mbajti të gjithëve derisa u realizua ky film. Kur flasim për anën konkurruese, ajo duket e relaksuar dhe e qetë, ngjarja vërtet stresuese ishte kur e shfaqti këtë film në qytetin e saj të lindjes, duke u pyetur se si do të reagonin njerëzit.

Është një përshkrim i papërpunuar i jetës së saj, prandaj reagimi ka qenë paralel me atë ndjenjë. Nga shkëputja nga personale, puna me një kamera të përlur, ajo na dërgon në një udhëtim vetëreflektimi, por duke u lidhur si kurrë më parë me përvojën e të qenit grua.

"E dini, kisha këtë dyshim, por në të njëjtën kohë, e dija se do të pritej shumë mirë nga gratë, sepse ka kaq shumë gra që kanë kaluar diçka të ngjashme." - thotë ajo.

Por pasojat e mënyrës se si u prit filmi në shfaqje të ndryshme kanë qenë ato të krijimit të një ndjenje të fuqisë së vajzës dhe ndarjes së historive thellësisht prekëse, dhe arritjes së një ndjenje çlirimi. Të bashkohesh është gjithashtu diçka që ndodh rregullisht në DokuFest, kur hëna vjen nga pas kështjellës, thotë ajo, ka një ndjenjë ribashkimi që është e pakrahasueshme. Ajo thotë, "thjesht mendoni se sa bashkëpunime kuptimplote kanë filluar vetëm nga një bisedë në këtë rrugë?"

Duke parë se çfarë na bën të gjithëve t'i besojmë njëri-tjetrit dhe të festojmë guximin e gjithë kësaj, e pastaj thjesht të reflektojmë së bashku, Dielli vazhdoi t'i afrohej Matejës ndërsa e mbaronim këtë bisedë, me gjithë bukurinë dhe fuqinë e saj.

General Sponsor	Principal Partner	Principal Partner	Golden Sponsor
			
		 	
			
			
  		